



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 20, Datë 26.02.2016

PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 57, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 7, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Atlantik-shoqëri sigurimesh” sh.a., si pasojë e zgjerimit të veprimtarisë, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Në statutin e shoqërisë së sigurimit “Atlantik-shoqëri sigurimesh” sh.a., bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në nenin 7, në fund, shtohet shprehja me këtë përmbajtje “...si dhe vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për miratimin e kërkesës për zgjerim veprimtarie në klasat 5 dhe 11 të sigurimeve”.